



Shkolla e Mesme Northeast

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Të nderuar prindër/kujdestarë ,

Fëmija juaj do të marrë pjesë në Provimin Keystone, një provim i standardizuar me mandat shtetëror gjatë 7-16 Janarit 2020. Detajet më poshtë dhe dokumentet e përfshira në faqen e internetit do t'ju japin informacione të rëndësishme, kështu që ju lutemi lexoni për disa minuta dhe shikoni informacionet. Dokumentet e përfshira në Uebsite (<https://neh.sphilasd.org/keystone/>)

1. Pyetjet e bëra më shpesh - Informacion për prindërit ose kujdestarët
2. Karakteristikat dhe kushtet e veçanta për provimin Keystone / PSSA
3. Letër prindërve në lidhje me pajisjet elektronike – Rregulla të hollësishme nga Departamentit i Arsimit të Pensilvanisë mbi dhe pasojat e përdorimit të telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike gjatë provimit.

Ligji shkollor për pajisjet elektronike

Siç shpjegohet në Letrën e Prindërve për Pajisjet Elektronike, të gjitha pajisjet elektronike si p.sh. telefona celularë, smartphone, kamera, dhe pajisje të tjera të komunikimit nuk do të lejohen gjatë administrimit të provimit.

Veprimet e mëposhtme do të ndërmerren nëse një nxënës është qjetur në dyshim të një pajisje elektronike gjatë provimit:

- Personeli i shkollës do të përcaktojë nëse është përdorur për të rrezikuar sigurinë ose integritetin e provimit
- Për nxënësit që shkelin rregullat në lidhje me ndalimin e përdorimit të pajisjeve elektronike, do t'u konfiskohet telefoni dhe vetëm do ti kthehet prindit ose kujdestarit pasi të kenë përfunduar të gjitha provimet dhe mund të përballen me masa disiplinore të tjera siç përcaktohet nga administrata.

Veprimet e mëposhtme do të ndërmerren nëse një nxënës është gjetur duke përdorur një pajisje elektronike gjatë provimit:

- Personeli i shkollës do të përcaktojë nëse është përdorur për të rrezikuar sigurinë ose integritetin e provimit.
- Për nxënësit që shkelin rregullat në lidhje me ndalimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike, gjatë provimit do të merren masa disiplinore duke e konfiskuar telefonin e tyre dhe do t'i kthehet vetëm prindit ose kujdestarit pasi të kenë përfunduar të gjitha provimet dhe mund të përballen me masa disiplinore të tjera të përcaktuara nga administrata.
- Një etiketë "Mos të Vlerësohet" do të aplikohet në broshurën e tij të provimit dhe nxënësi ose duhet të rimarrë provimin që nga fillimi ose të mos marrë asnjë rezultat, nuk do të vlerësohet.
- Pajisja elektronike e konfiskuar, në praninë tuaj, do të shikohet për të siguruar që nuk përmban asnjë informacion ose material në lidhje me provimin.
- Nëqoftese materialet e provimit janë rrezikuar, ato do të duhet të zëvendësohen. Prindëri / Kujdestari dhe nxënësi mund të jenë përgjegjës për koston e zëvendësimit.

Ju lutemi rishikoni me kujdes rregullat e mësipërme dhe diskutoni ato me fëmijën tuaj. Si gjithmonë, ne presim bashkëpunimin tuaj të plotë në këtë çështje të rëndësishme.

Sinqerisht,

Z. Omar Crowder

Drejtori i shkollës